



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika "b" të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe nenit 19, al.1, pika "b" të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2004 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË
GJYKATËS KOMUNALE DHE TË GJYKATËS PËR KUNDËRVAJTJE NË
PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 7582, 7583, 7584/4, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 2.2 ha.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhshëm rregullativ të hapësirës më të gjerë ku ndodhet ky lokacion.

Neni 4

Ky Vendim paraqetë bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. 353-3381 DT. 07.12.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri